



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:279014
Datë: 06.11.2024
Numri i dokumentit: 06412848

C-III-24-0138

Paditësi - Propozuesit:

- M M–C, Prishtinë
- F M, Ferizaj
- R I Fshati S, Viti
- F M Prishtinë
- E I– Fshati K, Ferizaj
- H M– Fshati S e P, Viti, të gjithë të përfaqësuar nga M M–, C, Prishtinë

Kundër

E paditura – Kundër propozuese:

NSh “Agromorava” e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha ” nr. 55, Lakrishtë –Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese e kolegjit, dhe gjyqtarët Djellza Hoxha e Gazmend Sylaj anëtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.06 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pabazuar .**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.08 tetor 2024, paditësit - propozuesit kanë parashtruar padi në DHPGJS, me propozim për masë të sigurimit, për ndalimin e shitjes, ndërrimit apo dhurimit të ngastrës kadastrale me numër të njësisë nr.. në sipërfaqe prej 1,10.00 m2 (një hektar e dhjetë ari), ZK S.

Sipas padisë së paditësve me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Viti C.nr.128/94 të dt.07.09.1994 , babait të paditësve tani i ndjerë H M i është njohur e drejta e pronësisë në ngastrën kadastrale nr., në vendin e quajtur “..” (..), nga arsyeja se paraardhësi i paditësve e kishte blerë këtë paluajtshmëri nga e paditura NSh “Agromorava” në Viti.

Sipas padisë kjo pasuri e paluajtshme në regjistrat kadastral në Komunën e Vitisë, ende dhe atë gabimisht evidentohet në emrin e ndërmarrjes shoqërore “Agromorava” nga Viti.

Paditësit theksojnë se që nga viti 1994 ata janë në posedim të lirë të ngastrës kadastrale që është objekt i kësaj padie. Mbi bazën e këtij aktgjykimi, babai i paditësve kishte filluar procedurën përmbartuese për regjistrimin e pronësisë ashtu që Gjykatat Komunale në Viti së bashku me elspretin e gjeodezisë i kishin nda kreditorit – H M sipërfaqen prej 1,10.00 m2 dhe kishin përcaktuar kufinj të kësaj paluajtshmërie, duke ia dhënë në posedim e që nga kjo kohë të njëjtën e kanë shfrytëzuar lirshëm. Andaj, paditësit kanë propozuar që gjykata të Aprovoj kërkesëpadinë e tyre dhe të vërtetohet se paditësit janë bashkëpronarë ligjor të ngastrës kadastrale nr.. në sipërfaqe prej 1,10.00 m2 ZK Sllatinë dhe të obligon të paditurën që paditësve t’ua njoh këtë të drejtë të pronësisë dhe t’ua lejoj që në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Vitisë, paditësit të regjistrojnë të drejtën e pronësisë në librat kadastral.

Poashtu paditësit, kanë propozuar caktimin e Masës së sigurisë me të cilën do të **Ndalohe** të paditurës tjetërsimi (shitja, ndërrimi apo dhurimi) i ngastrës kadastrale nr. të njësisë nr.. në sipërfaqe prej 1,10.00 m2 ZK Sllatinë, deri në përfundimin e kësaj lënde kontestimore.

Paditësit së bashku me padi kanë bashkëngjitur:

- Kopjen e Aktit Noterial nr. LRP.nr.rend.5820/2024
- Kopjen e certifikatës së Agjencisë Kadastrale të Kosovës
- Kopjen e planit të lëshuar nga Agjencia Kadastrale e Kosovës me nr. P-70101037-01427-0 e dt. 07.10.2024
- Çertifikatën e lëshuar nga Agjencioni kadastral i Kosovës për njësin kadastrale P-.. e dt.
- Kopjen e vendimit të lëshuar nga Gjykata Komunale në Viti me nr. 32/94 i dt. 26.09.1994,
- Kopjen e parashtrësës ku paditësi ka njoftuar AKP-në për parashtrimin e padisë pranë DHPGJS-së.

Me dt. 09.10.2024, gjykata ka dërguar vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi dhe masë të sigurisë dhe pas tre tentimeve nga ana e postës zarfi është kthyer me konstatimin se marrësi në adresën e dhënë është i pa njohur.

Andaj në numrin kontaktues të paditësit Gjykata ka njoftuar të njëjtin për mosrealizimin e dërgesës së urdhërit nga ana e shërbimit postar dhe i njëjti me dt. 01 nëntor 2024 ka pranuar vërejtjen dhe të njëjtën ditë ka bërë pagesat për masë të sigurisë dhe për ushtrim të padisë .

Me dt. 22 tetor 2024, gjykata ka pranuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit përgjigjen në padi dhe përgjigjen në kërkesën për masë të sigurisë. Sipas mbrojtjes paditësit kanë ushtruar padinë në kundërshtim me parimin procedural “*legitimaio ad causam*” pasi që të njëjtëve u mungon legjitimiteti aktiv për procedim të çështjes gjyqësore ngase, nuk kanë ofruar dëshmi për të vërtetuar se janë trashëgimtar të paraardhësit të tyre siq parashifet me nenin 171 të *Ligjit mbi procedurën jokontestimore* –Ligji nr 03/L-007. Ashtu që ka propozuar që të hudhet padia e paditësve si e papranueshme.

Ndërsa, sa i përket propozimit për masë të sigurisë e paditura ka theksuar se paditësi propozimin nuk e ka mbështet në fakte dhe mjete provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e tij, si për dëmin e menjëhershëm ashtu edhe për dëmin e pariparueshëm dhe ka propozuar që kërkesa e propozuesve të sigurimit për lëshimin e Urdhërit praparak Gjyqësor –masës së sigurisë, të Hudhet poshtë si i papranueshëm apo të refuzohet si i pa bazuar.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit, refuzohet si e pabazuar.

Sipas Nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon urdhër praparak gjyqësor duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
 2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.
- Barra e provës është tek paditësi, kështu që paditësi përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshëm faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Ekzistimi i së drejtës së pretenduar

Pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, Kolegji vlerëson se paditësit në këtë fazë të procedurës, nuk kanë dorëzuar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar në favorin e tyre. Andaj, meqenëse paditësi ende nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës së pretenduar vetëm pretendimi i tij se është pronar i palujtshmërisë dhe të njëjtën e ka shfrytëzuar nuk mund të merret si provë për caktimin e masës së sigurisë.

Dëmi i menjëhershëm

Gjykata vlerëson se nuk është plotësuar as kushti për dëm të menjëhershëm për caktimin e Masës së sigurimit, pasi që paditësi nuk e ka paraqitur ndonjë rrethanë, nga e cila pritet të pësojë ndonjë dëm të menjëhershëm dhe se nuk ka dorëzuar dëshmi të besueshme se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Paditësi ka dorëzuar provat me të cilat konsideron se i takon e drejta në pronën kontestuese, mirëpo të njëjtat nuk e bëjnë të besueshëm këtë pretendim, e veçanërisht kopja e certifikatës pronësore për njësin kadastrale tani kontestuese, vërteton të kundërtën ngase shifet se kjo pronë është e regjistruar në pronësi të N.B.I. Q. “ Agromorava “ Viti të cilën e përfaqëson Agjencia Kosovare e Privatizimit

Dëmi i pariparueshëm

Sipas dispozitave ligjore dëmi konsiderohet si i “pariparueshëm” vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar. Në rastin konkret, as kushti për dëm të pariparueshëm, si kusht për tu caktuar masa e sigurimit nuk është plotësuar.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimin e të paditurës lidhur me legjitimitetin aktiv të paditëseve mirëpo, për këtë do të vendos me rastin e marrjes së vendimit për meritat e padisë.

Në këtë rast gjykata nuk ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), paditësi si palë e pasuksesshme do të mbulojë shpenzimet e veta. Pala paditëse e ka paguar taksën gjyqësore për propozim për caktim të masës së përkohshme të sigurisë .

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, gjyqtare Kryesuese _____

Djellza Hoxha , gjyqtare _____

Gazmend Sylaj, gjyqtar _____